

AKT THEMELIMI

I Shoqerise me Pergjegjesi te Ku.fizuar "Albanian Beauty Society" shpk

Ne Tirane, sot me date 08 Nentor 2024, ne cilesine e "ortakut themelues":

Znj. Sara MALAJ, atesia Endrit, i dtl. 13.06.1995, lindur ne Tirane, Shqiperi, dhe banuese ne Laprake, Tirane, shtetase shqipetare, madhore, me zotesi jurdike dhe per te vepruar, mbajtes pasaportes me numer BC9309934 dhe numer personal J55613066N, e cila me cilesine e "ortakut themelues ", me vullnet te lire, te plate e te sinqerte, harto kete akt themeli per krijimin e shoqerise per gjegjesi te kufizuar me emertimin **"Albanian Beauty Society" shpk** mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1 Krijimi

Shoqeria **"Albanian Beauty Society" shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me per gjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"). **Emri tregtar i shoqerise " Albanian Beauty Society"**

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria **" Albanian Beauty Society" shpk**, eshte nje shoqeri tregtar, e themeluar nga "ortaket e shoqerise", te cilet nuk per gjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ortaket gezojne kuoten e tyre ne shoqeri, ne perpjesetim me kontributin qe kane dhene ne kapital.

Neni 3 Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Tirane, ne adresen Njesia Bashkiake nr.8, Rruga Qemal Stafa, nr.31, Shk.B, Ap.2/1001, Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut te Shoqerise.



Neni4
Objekti i veprimtarise

Import-Eksport, tregti me pakice e shumice artikujve te ndryshme te kozmetikes.

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000 leke.

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga "ortaket e shoqerise"

Znj. Sara Malaj, eshte zoteruese i 1 kuote me vlore 1,000 leke, e cila perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te shoqerise

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimive te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Asambleja e Ortakut ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim nga Administratorii, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;



- c) trasheqimise;
- c) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate per gjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trasheqimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Ortakut, vendos per c;:eshtje si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorieve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- c) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratoriet, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje register te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shpemdarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec; rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni perte.

Neni 10 Administrimi

Administratorja e shoqerise eshte: **Znj. Sara Malaj**

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te



dreje riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e Ortakut te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11 Kompetencat

Administratori ka te dreje e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Ortakut;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- c) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asambleja e Ortakut per miratim;
- d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic; parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posac;me me rendesi te vec;ante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe ne rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose episton rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit: te tij, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.


Administratorii ka te dreje te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratorii perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoriteteteve doganore, perfshi ketu edhe autoritetet gjiqesore te gjitha shkallevet. Administratorii angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tij.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i Administratoreve e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk round ta injoronin kete akt ne rr Ethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 12 Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Ortakut qe i sjellin dem shoqerise, i



ngarkohen Administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e perjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoquerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoquerise ne mjesid;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me perjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoquerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyras se tij, per gjigjet ndaj shoquerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoquerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese Administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoquerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara., Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administratori, ata per gjigjen ndaj shoquerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, Administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoquerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e meposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shpemdan aktivet shoquerise;

c) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare , duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;


d) jep kredi.

Neni 13 Viti Financiar

Viti finanziar i Shoquerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistri mit te shoquerise ne Qendren Kombet are te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 14 Bilanci i shoquerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asambleja e Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratorii.



Mbledhja e Asambleja e Ortakut vendos rrith shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financier , sic edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoquerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "**Albanian Beauty Society**" shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plote te "ortakut themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe.

**ORTAKET E
SHOQERISE**

SARA MALAJ

